



MOS U PLAKSH

Raport mbi standardin e jetesës
së të moshuarve të Kosovës



INICIATIVA KOSOVARE PËR STABILITET
KOSOVAR STABILITY INITIATIVE

PËR IKS

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është institut kërkimor i pavarur, jofitimprurës që fokusohet në hulumtime dhe analiza empirike të zhvillimeve socioekonomike në Kosovë. IKS-ja u themelua në vitin 2004 duke parë nevojën e madhe për analiza të pavarura e të thukta të çështjeve të rëndësishme që ndërlidhen me promovimin e stabilitetit dhe të prosperitetit në Kosovë. Hulumtimet e saj inovative dhe të orientuara drejt politikave kanë për qëllim të nxisin debate rreth çështjeve të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës

Ne besojmë se debatet publike të bazuara në argumente përbëjnë thelbin e vendimmarrjeve demokratike dhe të transformimit ekonomik të vendit. IKS-ja nuk ka përkatësi politike, partiake apo organizative të çfarëdo lloji.

Ekipi me përvojë të gjerë dhe shumëdimensionale i IKS-së është i përkushtuar ta arrijë synimin e vet. Bordi Këshillëdhënës me analistë e ekspertë vendorë e ndërkombëtarë gjithashtu mbështetë punën e saj.

Që nga themelimi, IKS-ja ka zhvilluar një sërë projektesh hulumtimi empirik të përqendruara në çështjet siç është qeverisja, zhvillimi ekonomik, planifikimi urban, trashëgimia kulturore, korrupsioni në rindërtimin e pasluftës, çështjet e mjedisit, arsimit, problemi i imazhit të Kosovës si dhe struktura e tanishme e ngatërruar qeverisëse.

IKS-ja është pjesë e rrjetit të frymëzuar nga Iniciativa Europiane për Stabilitet, me shtrirje në mbarë Europën Juglindore dhe anëtare e asociuar e ECAS-së.

Të gjitha raportet mund të shkarkohen pa pagesë nga uebfaqja jonë.

PASQYRA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	1
SHPËRFAQJA E SË VËRTETËS.....	2
PËRFUNDIMET.....	16
BIBLIOGRAFIA.....	18
SHTOJCË - ANKETA E STANDARDEVE TË JETESËS SË TË MOSHUARVE.....	19



HYRJE

Kosova është një shtet i vogël: është gjithashtu shteti më i ri në Evropë . Moshë mesatare e popullsisë së Kosovës prej 1.7 milionë banorëve është 30 vjet, dhe vetëm 6.2% janë të moshës 65 apo mbi 65-vjeç.¹ Me një pjesëmarrje të vogël në elektorat, të moshuarit janë shpërfillur për një kohë të gjatë nga politikanët tanë dhe ndryshe nga disa prej fqinjëve tanë, ne nuk kemi parti të fuqishme të pensionistëve. Por as natyra e shoqërisë kosovare nuk ndihmon shumë në këtë aspekt. Meqenëse për të moshuarit gati gjithmonë përkujdesen familjet e tyre, interesat e tyre në masë të madhe shpërfillen nga shoqëria. Ata shpërfillen nga shoqëria civile dhe nuk ka shumë vullnet nga qeveria apo nga sektori privat për të krijuar ente të posaçme të kujdesit për të moshuarit, për t'u ndihmuar atyre që e kanë humbur pavarësinë, apo për të siguruar qasje në shërbime adekuata sociale të cilat sot ose nuk ekzistojnë ose nuk janë të përshtatura si duhet me natyrën e shoqërisë sonë. Ky është konteksti i këtij studimi mbi kushtet e jetesës së të moshuarve të Kosovës të cilët këtu definohen si persona të moshës 65 apo mbi 65-vjeç.

Meqenëse për të moshuarit gati gjithmonë përkujdesen familjet e tyre, interesat e tyre në masë të madhe shpërfillen nga shoqëria.

Qasja në shërbimet shëndetësore specifiku për të moshuarit dhe investimet në përkujdesjen ndaj personave në moshë apo me dementia është shpërfillur nga të gjitha qeveritë, strukturat politike si dhe nga publiku në tërësi. Qëllimi i këtij studimi është të ngritet vetëdijësimi për çështjen shumë aktuale të kujdesit për të moshuarit e Kosovës – pjesë e popullsisë e cila vetëm sa do të rritet në vitet dhe dekadat në vijim.

Në këtë studim kemi bërë një kombinim hulumtimi cilësor dhe sasior. Hulumtimi i burimeve ekzistuese u zhvillua për të vlerësuar situatën e të moshuarve: kemi analizuar informacione në dispozicion të publikut nga Agjencia Statistikore e Kosovës dhe raportet e hartuara nga organizatat ndërkombëtare, siç është Banka Botërore dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara. Ky aktivitet u mbështet me hulumtimin tonë sasior në formë të anketës. Kemi anketuar 600 persona të moshës 65 apo mbi 65 vjeç, të zgjedhur në mënyrë rastësore nga një mostër e gjerë, e cila u përzgjedh si bazë e statistikave pensionale, statusit socioekonomik dhe përbërjes etnike. Mostra gjithashtu përfshiu banorë të 35 fshatrave reprezentative, të cilat shtrihen brenda kufijve komunalë të shtatë zonave urbane në: Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Nga të anketuarit, 34% gra dhe 36% burra ishin nga zonat rurale, derisa pjesa tjetër janë nga zonat urbane.

¹ Agjencia Statistikore e Kosovës, Vjetari Statistikor 2017.



"Ne, pensionistët, jemi klasa më e pafavorizuar në botë që nga paslufta".

SHPËRFAQJA E SË VËRTETËS


Vetëm 6.2% e popullsisë në Kosovë është në moshën 65 apo mbi 65-vjeç.² Ndryshe nga pjesët e tjera të Europës dhe të Ballkanit Perëndimor, qytetarët e moshuar përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të popullsisë së përgjithshme. Megjithatë, edhe pse e kanë kaluar tërë jetën duke i shërbyer Kosovës dhe duke paguar taksa, ata shpeshherë harrohen dhe shpërfillen si nga shteti ashtu edhe nga shoqëria.

² Ibid. Përqindja e siguruar pas përlogaritjeve duke u bazuar në grupmoshat e tjera.

Anketa jonë gjeti se 88% e pensionistëve të anketuar do të donin të shihnin më shumë përfshirje në aktivitete të cilat i kushtohen grupmoshës së tyre nga organizatat e shoqërisë civile, për shembull në fushën e vullnetarizmit.

Derisa shoqëria civile i shpërfill të moshuarit, vet shteti u ka lënë përgjegjësinë familjeve të cilat obligohen me ligj që të kujdesen për anëtarët e tyre të moshuar, pavarësisht situatës së tyre financiare.³ Në Kosovë, 17.6% e popullsisë jeton nën pragun e varfërisë.⁴ Kjo ka pasoja direkte dhe negative në standardet e jetesës së atyre të moshuarve të cilët hyjnë brenda këtij segmenti të shoqërisë, në mundësinë e tyre për të marrë kujdesin e nevojshëm shëndetësor, dhe për të jetuar me dinjitet dhe të pavarur.

Pensionet e vogla shtetërore i kufizojnë opsionet për të moshuarit. Ato thjesht nuk mjaftojnë për t'i mundësuar dikujt të jetojë me pak apo pa asnjë burim tjetër të të ardhurave për të jetuar vetëm. Kjo i detyron ata të jetojnë me familjet e tyre, me apo pa dëshirën e tyre, duke shkaktuar mbipopullim të hapësirës.



Kështu, madhësia standarde e hapësirës për kokë banori në Kosovë në një familje mesatare gjashtanëtarëshe shtrihet nga 8.5m² deri në 16.6m⁵.

Përkundër kësaj, rreth 2.6% e pensionistëve jetojnë vetëm.⁶ Për ta, privimi nga pronësia diskrepanca në pronësi mund të jetë një faktor tjetër që i kontribuon standardit të dobët të jetesës dhe mungesës së autonomisë së tyre financiare. Gratë e moshuara rrallëherë janë pronare të shtëpive të tyre që i bën veçanërisht të cënueshme ndaj abuzimit dhe varfërisë ekstreme. Edhe pse përqindja e të moshuarve që jetojnë vetëm është mjaft e vogël, çështja e intervenimit të shtetit dhe të shoqërisë civile për t'u siguruar kujdes dhe shërbime atyre është

³ Ligji Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit. Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare


⁴ Agjencia Statistike e Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2017, <http://ask.rks-gov.net/media/3637/statistical-yearbook-of-the-republic-of-kosovo-2017.pdf>.

⁵ IKS Anketa e Standardit të Jetesës së të Moshuarve, 2017.

⁶ Socioeconomic conditions of elderly people in Kosovo: a cross-sectional study, 2012, BMC Public Health.

zhgënjyese. Në vitin 2017, asnjë organizatë joqeveritare, private apo bamirëse, nuk ka qenë e licencuar të ofrojë kujdes të specializuar për të moshuarit. Në fillim të vitit 2008, dhjetë vjet pas luftës, shteti siguroi vetëm disa shërbime të vogla për të moshuarit dhe një numër të vogël institucionesh. Shtëpitë e të moshuarve janë ndër këto institucione e megjithatë vetëm katër sosh janë në mbarë Kosovën, dhe kriteret e pranimit në to gati i pamundësojnë atyre banimin aty. Ato gjithashtu janë dëshmuar të mos jenë të përshtatura si duhet me kontekstin social dhe familjar në Kosovë dhe, nga ajo që kemi mbledhur gjatë hulumtimit, shërbimet dhe pajisjet e tyre janë të dobëta. Duke qenë se familja është bërthama dhe themeli i shoqërisë, bartja e përgjegjësisë së përkujdesjes për anëtarët e familjes të cilët kanë nevojë për kujdes, sidomos për të moshuarit, ende shihet me sy të keq. Çështjet të cilat lindin nga përgjegjësia jonë kolektive e përkujdesjes për të moshuarit tanë kanë shumë elemente: shumë përballen me vështirësi financiare për të siguruar ndihmë adekuate për ta, meqë të moshuarit nuk mund të mbijetojnë me pensionet e tyre shtetërore pa mbështetjen e familjeve të tyre. Derisa shteti ofron siguri sociale minimale në formë të pensioneve, shteti nuk ofron asnjë beneficion tjetër të sigurimit social për nevojtarët. Shoqëria civile gjithashtu nuk ia del të bëjë shumë, duke i lënë të moshuarit tanë krejtësisht të varur nga familjet e tyre apo të gjinden si dinë vet. Varësia e tyre nga familjet e tyre për të mbijetuar

është rezultat direkt i gjendjes së tyre të keqe financiare. Pensioni bazik i moshës është hiç më shumë se 75 euro në muaj derisa ai kontributpagues fillon prej 145 eurove⁷. Disa që kanë punuar jashtë vendit marrin pensione nga jashtë, por është e pamundur të vlerësohet shuma apo numri i personave të tillë.



Duke i marrë parasysh shpenzimet mujore minimale të ushqimit, që janë rreth 68 euro për person apo 246 euro për një familje tipike, është e qartë se pensionet shtetërore janë tejet të vogla për të siguruar standard të denjë të jetesës.⁸ Anketa jonë tregon se 75% e të anketuarve shpenzojnë 31 euro apo më shumë për ushqim gjatë javës, ose rreth 124 euro në muaj, që është gati dyfishi i kostos minimale mujore të ushqimit. Një arsye e mundshme për këtë


⁷ IKS, Studimi i Pagës MInimale, 2016.

⁸ Ibid.

mospërputhje është se të anketuarit kanë dhënë shifrën për çift dhe jo për individ. Në anën tjetër, kostoja e shërbimeve komunale arrinë në 31 euro për familje në muaj sipas 88% të të anketuarve, derisa 63% prej tyre shpenzojnë deri në 50 euro në muaj për barna.⁹

Përveç që pensionet nuk mjaftojnë për t'i plotësuar nevojat themelore të të moshuarve, në rast të largimit të tyre prej familjeve ata rrezikojnë të bien varfëri të skajshme dhe mezi do të mund të mbijetonin.¹⁰ Ndër pasojat e tjera, kjo mund të ketë ndikim shkatërrues në shëndetin e tyre edhe ashtu të brishtë. Varfëria është faktor social dhe ekonomik e cila e rritë ndjesinë apo realitetin e shëndetit të ligë.

41% e të anketuarve tanë konsiderojnë se shëndeti i tyre është i ligë derisa 43% kanë deklaruar se rrethanat e tyre shëndetësore pengojnë kryerjen e aktiviteteve të tyre ditore.¹¹




Varfëria apo brishtësia ekonomike mund t'i rrisë edhe më shumë këto përqindje. Për një përqindje të madhe të të anketuarve, jeta e përditshme është kryesisht joaktive dhe zhvillohet në hapësira të brendshme. Më shumë se 44% e të anketuarve deklaruan se nuk merreshin me aktivitete fizike, por 34.5% e të anketuarve u përgjigjën se ata angazhohen në aktivitete të tilla siç është kopshtaria, ecja dhe ushtrimet e përgjithshme.

⁹ IKS Anketa e Standardit të Jetesës së të Moshuarve, 2017

¹⁰ Pragu i varfërisë është vendosur në më pak se 2 dollarë në ditë, sipas Bankës Botërore. Me 75 euro në muaj, përfituesi do të mund të mbijetonte me 2.5 euro në ditë dhe me 145 euro në muaj, përfituesi do të mund të mbijetonte me 4 euro në ditë.

¹¹ IKS Anketa e Standardit të Jetesës së të Moshuarve, 2017.



Shumica dërmuese asnjëherë nuk kanë shkuar në teatër apo nuk kanë parë ndonjë film ose ekspozitë, edhe pse në vitin 2017 kishte rreth 667 aktivitete të tilla. Përveç kësaj, me shumë pak klube për pensionistë dhe thuajse asnjë qendër të kujdesit ditor me hapësira të përshtatshme për të moshuarit, izolimi dhe mungesa e ushtrimeve fizike e mendore, mund t'i kontribuojnë mirëqenies së dobët fizike dhe mendore, që me shumë gjasë shkakton pasoja siç është dementia e Alzheimeri.¹² Prej mostrës sonë, 90% e të anketuarve thanë se familjet e tyre i mbështesnin me shpenzime për barna dhe asnjëri nuk kishte sigurim shëndetësor privat. Kjo, përveç të ardhurave të vogla, i bën krejtësisht të varur nga familjet për mbijetesë.

Në Kosovë, ku varfëria është e shumëpërhapur, shkalla e papunësisë arrin në më se 30.6%, derisa të ardhurat mesatare janë 354 euro në muaj, ndër më të ulëtat në Evropë.¹³ Në vitin 2015, një grup prej më se 75,000 personash të moshës 20 deri në 64 vjeç, megjithëse shumica në moshën e re të këtij spektri, u larguan nga vendi dhe shumë prej tyre nuk morrën me vete as familjen e lëre më prindërit.¹⁴ Kështu, ky sistem dhe kjo situatë sociale dhe ekonomike nuk është e qëndrueshme.


¹² Qendra rekreative në Tophane-Prishtinë ende pritet të hapet.

¹³ IKS, Studimi i Pagës Minimale, 2016

¹⁴ Agjencia Statistikore e Kosovës, Llogaritja e Popullsisë së Kosovës, 2015

<http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-nees/estimation-of-kosovo-population-2015>

Sipas mendimit tuaj, sa duhet të jetë pensioni juaj për t'i mbuluar nevojat tuaja elementare?



Remitencat janë burimi kryesor i të ardhurave për më se 90% të të anketuarve.¹⁵ Vetëm 0.5% e të anketuarve pohuan se merrnin pensione nga jashtë, megjithëse numri real mund të jetë shumë më i lartë. Sipas ligjit, pensionistët kosovarë të cilët kanë punuar jashtë

vendit dhe marrin pensione nga jashtë por janë kthyer në Kosovë, nuk mund t'i marrin të dy pensionet.¹⁶ Në atë rast, shumica dërmuese e atyre të cilët marrin pension nga jashtë nuk e deklarojnë atë, që të mund t'i marrin të dy pensionet dhe kjo mund të jetë arsyeja përse shumë pak persona deklaruan se nuk merrnin pensione nga jashtë. Shumë prej këtyre njerëzve e ruajnë adresën dhe llogarinë bankare jashtë vendit për ta bërë më të lehtë marrjen e pensionit nga jashtë dhe për të zvogëluar rrezikun e zbulimit.

Sipas shifrave të migrimit të Agjencisë Statistike të Kosovës, 380,826 persona apo 21.4% të qytetarëve të Kosovës jetojnë jashtë vendit, megjithëse këto shifra nuk i përfshijnë ata të cilët jetojnë në Serbi. Vetëm 1.3% e atyre të cilët emigrojnë janë të moshës mbi 65-vjeç, ndërsa prej atyre të cilët tashmë janë jashtë vendit, 19.4% janë të varur, pra fëmijë apo të moshuar. Andaj, numri i saktë i të moshuarve që jetojnë jashtë vendit nuk dihet. Statistikat e kësaj agjencie gjithashtu tregojnë se në vitin 2016, 691 milionë euro iu dërguan familjeve në Kosovë si remitenca, por shifra e përllogaritur reale duhet të jetë afër 1.5 miliardë euro. Shifra e parë përbën 11.5% të GDP-së, derisa e dyta përbën 25% të GDP-së,¹⁷ duke dëshmuar kështu se sa jetike janë këto të ardhura shtesë për Kosovën dhe popullsinë e saj.

¹⁵ IKS Anketat e Standardit të Jetesës së të Moshuarve të Kosovës, 2017.

¹⁶ Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

¹⁷ Agjencia Statistike e Kosovës, Vjetari Statistikor 2016. Këto janë shifra zyrtare të publikuara nga Departamenti i Statistikave. Megjithatë sipas një përllogaritjeje të UNDP-së (Kosovo Human Development Report, UNDP, 2014), rreth 1,5 miliardë euro në vit u dërgohen kosovarëve nga familjet jashtë vendit, që përbën rreth 25% të GDP-së së Kosovës sipas Vjetarit Statistikor 2017 të ASK-së.

Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për pensione nga vendet e huaja, prapëseprapë është e qartë se shumë familje varen nga remitencat në përgjithësi, megjithatë, të pritët nga çdo familje kosovare të sigurojë kujdes adekuat për të moshuarit dhe të obligohen me ligj për një gjë të tillë është joreale. Për më tepër, përveç zvogëlimit të standardit të tyre të jetesës dhe mënyrës se si ata i sheh shoqëria, kjo do t'i shërbente edhe thellimit të varfërisë. Pikërisht lidhur me të ardhurat, më shumë se 60% e të anketuarve tanë u ankuan për të ardhurat e tyre të ulëta dhe se do të dëshironin që ato të rriteshin ndërmjet 300 dhe 500 euro në muaj.

Derisa të moshuarit në përgjithësi janë në rrezik më të madh për të rënë në varfëri se sa pjesa tjetër e popullsisë, gratë janë më tepër të ekspozuara ndaj këtij rreziku. Përderisa të ardhurat e shumicës së të moshuarve të anketuar ishin 150-200 euro në muaj, rreth 80% e grave të moshuara deklaruan të ardhura prej 70-100 euro, pra sa gjysma e të ardhurave të burrave.¹⁸ Ndër arsyt kryesore për këtë është pikërisht pensioni kontributpagues, pasiqë 60% e burrave përfitojnë nga kjo skemë kundrejt vetëm 9% të grave. Shuma e pensionit kontributpagues është afro dyfishi i shumës së përfituar nga pensioni bazik, i cili fillon prej 75 eurove në muaj, e që është shuma që e merr shumica e pensionistëve (mbi 120.017)¹⁹. Ky dallim pasqyrohet në nivele të punësimit: në vitin 2017, vetëm 12.7% e grave ishin të punësuar me paga kundrejt 46.7% të burrave,²⁰ ndërsa prej grave të anketuara, 79% kurrë nuk kishin pasur një punë me pagë para pensionimit. Kjo diferencë masive ka pasojë direkte në situatën ekonomike të burrave dhe të grave në pensionim, dhe shpjegon hendekun ndërmjet të ardhurave të tyre dhe arsyen përse shumica e grave futen në skemën e pensionit bazik dhe jo në atë kontributpagues.

¹⁸ IKS Anketa e Standardit të Jetesës së të Moshuarve në Kosovë, 2017.


¹⁹ Agjencia Statistikore e Kosovës, Pensionet Bazike në Kosovë më 2016, http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxëeb/en/askdata/askdata_16%20Welfare%20and%20health_01%20Welfare/sociale02.px/table/tableViewLayout1/?rxid=8049d19e-82ee-4979-a13c-37f537360aae

²⁰ Agjencia Statistikore e Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2017, <http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/labor-force-survey-in-kosovo-q2-2017>



“Askush nuk kujdeset për ne. Ne duhet të paraqitemi personalisht çdo gjashtë muaj në Ministri, për të dëshmuar se jemi ende gjallë, se ende jetojmë. Unë u shtriva në spital për shtatë muaj me radhë, dhe nuk kisha mundësi të paraqitesha personalisht. Andaj, nuk e mora pensionin për atë periudhë”.

Kush është pronari i shtëpisë?




Përveç kësaj, diskriminimi gjinor është gjithashtu i pranishëm sa i përket pasurisë kapitale dhe materiale. Edhe pse, sipas ligjit të trashëgimisë, gratë dhe vajzat kanë të drejtën e barabartë të trashëgimisë, përgjithësisht pritet prej tyre të heqin dorë nga e drejta e tyre në favor të trashëgimtarëve të gjinisë mashkullore.²¹ Prej grave të anketuara, vetëm 11% e grave të martuara janë pronare apo pjesërisht pronare të pronës në të cilën jetojnë dhe, edhe kur mbesin të veja, vetëm 25% prej tyre mbesin pronare.²² Prona në të cilën jetojnë zakonisht është

²¹ Ligji Nr.2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë, Neni 3 dhe Neni 11.

²² IKS Anketa e Standardit të Jetesës së të Moshuarve në Kosovë, 2017.

në pronësi të bashkëshortit ose të të birit, ose ka mbetur në emrin e bashkëshortit (apo të ndonjë të afërmi tjetër) edhe nëse ata kanë vdekur para shumë kohe. Ky fenomen më shumë ligjor se sa kulturor e zakonor, shpesh e tejkalon ligjin bashkëkohor për shumë familje, dhe i

Vetëm gratë: Me çka merreshit para se t'i mbushni 65 vjet?



ka privuar shumë gra të bëhen pronare si dhe e ka rritur varësinë e tyre ndaj bashkëshortëve dhe të afërmeve të gjinisë mashkullore. Kjo i bën gratë të cënueshme ndaj çfarëdo ndërprereje apo përçarjeje familjare, meqë ato lehtësisht mund të dëbohen nga shtëpia e tyre pa ndonjë pasojë apo kompensim dhe pa kurrfarë mbrojtjeje me ligj. Prona është shpeshherë posedimi më i vlefshëm i personit, dhe në rast të varfërisë personi gjithmonë mund ta shesë atë për ta zbutur situatën e vështirë ekonomike. Megjithatë, për gratë e sidomos për ato të moshuara të cilat nuk kanë pronë dhe të cilat varen krejtësisht prej familjeve të tyre, largimi nga shtëpia mund të jetë katastrofal dhe t'i lë pa asgjë. Kjo situatë e pasigurtë ilustron diskriminimin gjinor kundër grave përveç diskriminimit ekzistues me të cilin ballafaqohen qytetarët e moshuar.


Për gratë të cilat nuk posedojnë pronë dhe të cilat janë krejtësisht të varura nga familjet e tyre, largimi do të ishte katastrofal meqë ato do të liheshin pa asgjë.

Çështja e largimit prek vetëm një numër të vogël të moshuarish. Diku 2.6% prej tyre jetojnë vetëm dhe, natyrisht kjo nuk do të thotë se automatikisht asnjëri prej tyre nuk merr mbështetje prej familjes. Kështu, nga gjithsej 116,785 qytetarë të moshës 65-plus, 2.6% e tyre apo vetëm 3,036 persona, nuk kanë kurrfarë kontakti me familjet e tyre.²³ Megjithatë, të

²³ Agjencia Statistikore e Kosovës, Vjetari Statistikor 2017. Numrat e fituar pas llogaritjeve të bazuara në grupmosha të tjera.

larguar apo jo, përgjegjësia e shtetit për të siguruar shërbime për të gjithë pensionistët megjithatë duhet vënë në praktikë. Nga të gjithë të anketuarit, 94% besojnë se shteti ka përgjegjësi të kujdeset për ta dhe 69% besojnë se shteti po dështon në këtë aspekt.

A është shteti aktiv në kujdesin për të moshuarit?




Sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe sipas shërbimeve sociale të Kosovës detyrat e të cilave janë të përkufizuara me

rregulloret e Skemës së Ndihmës Sociale, qytetarët e moshuar gëzojnë të drejtën e ndihmës në shtëpi dhe të kujdesit shëndetësor përmes Qendrave për Punë Sociale apo organizatave joqeveritare.²⁴ Megjithatë, në praktikë, ndihma në shtëpi dhe obligimet e kujdesit shëndetësor shpeshherë përbushen nga anëtarët e familjes me të cilët jeton shumica dërmuese e tyre.

Në Kosovë janë të regjistruar dhe të licencuar 834 ofrues shërbimesh sociale dhe familjare, shumica e të cilave janë ose biznese private, organizata jofitimprurëse ose iniciativa lokale. Ekzistojnë 23 OJQ të licencuara për të ofruar shërbime sociale dhe familjare.²⁵ Megjithatë,

A duhet të jetë shteti përgjegjës për sigurimin e mbrojtjes adekuatë për të moshuarit?



asnjë prej këtyre shërbimeve dhe asnjëra prej këtyre organizatave nuk ofrojnë në mënyrë specifike shërbime për të moshuarit. Ofrohen edhe disa shërbime publike shtesë, siç është transporti falas në disa autobusë lokalë në Prishtinë. Ndër organizatat joqeveritare, Caritas e

²⁴ Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare.

²⁵ Intervistë me Shefin e Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare, 21 shtator, 2017.

paraqet veten si ofruer lider i shërbimeve të tilla për të moshuarit, edhe pse nuk është e licencuar specifikisht nga shteti për një aktivitet të tillë. Megjithatë, në vitin 2016 Caritas mori 1.85 milionë euro fonde publike për aktivitetet e tij, por ka pak dëshmi të shërbimeve të ofruara. Vetëm tre prej 600 të anketuarve thanë se kishin dëgjuar për Caritas-in.

"Unë jetoj në kushte shumë të rënda sociale. Unë marr barna të cilat kushtojnë 70 euro në muaj, dhe nuk mund t'ia dal t'i blej ato".



Përveç katër shtëpive të të moshuarve të udhëhequra nga shteti, ekzistojnë edhe disa shtëpi të tilla private të cilat drejtohen nga organizatat bamirëse apo fetare. Ato nuk janë të licencuara të kujdesen për të moshuarit në mënyrë specifike, por rreth 25 prej tyre mund ta bëjnë këtë për një numër njerëzish që kanë nevojë për ndonjë lloj të kujdesit. Në praktikë, kjo do të thotë se ekziston mungesë e standardeve apo kontrollit shëndetësor dhe të sigurisë. Çdokush mund ta hapë një shtëpi private dhe licencimi nevojitet vetëm kur kërkohen fonde nga shteti. Hulumtimi ynë na bën të besojmë se ky sektor është megjithatë i përshkruar nga korrupsioni. Për kujdes specifik për të moshuarit nuk është licencuar askush, por për kujdes për të sëmurët, të varfërit dhe të hendikepuarit janë licencuar rreth 25 organizata.

Shtëpitë e të moshuarve të udhëhequra nga shteti gjenden në: Prishtinë, Istog, Skenderaj dhe Graçanicë, me një kapacitet total prej 172 vendeve që përbën 0.14% të popullsisë së moshës 65-plus.²⁶ Aktualisht, shtëpitë janë me kapacitet 63.5% me 109 vende të zëna.²⁷ Në përgjithësi,

²⁶ Intervistë me zyrtarin e Divizionit të Personave të Paaftë dhe të Moshuar, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 7 shtator, 2017.


²⁷ Intervistë me zyrtarin e Divizionit të Personave të Paaftë dhe të Moshuar, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 2 nëntor, 2017.

tre deri në katër banorë ndajnë një dhomë prej 12m²-16m², duke lënë rreth katër metra katror për person.²⁸ Kujdesi në këto shtëpi për qytetarët e moshuar kosovarë pa përkujdesje të familjes, rregullohet me ligj nëpërmjet Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2014²⁹. Megjithatë, kriteret e aplikimit janë shumë të rrepta. Vetëm personat pa fëmijë mund të banojnë aty. Në anën tjetër, nëse marrim parasysh strukturën e përgjithshme familjare dhe sociale të Kosovës, numri i të moshuarve pa familje që kujdeset për ta, është jashtëzakonisht i vogël. Ajo që megjithatë mbetet e paqartë nëse numri i vogël i njerëzve në këto shtëpi është rezultat i kriterëve jashtëzakonisht të rrepta të kualifikueshmërisë, apo rezultat i normave sociale të cilat konsiderojnë se dorëzimi i anëtarëve të moshuar të familjes tek të huajt në një ent të institucionalizuar dhe publik të përkujdesjes është çnderim dhe turp. Për shumëkë, kjo e vë në pikëpyetje aftësinë e familjes të sigurojë edhe nevoja materiale e edhe ato financiare të të moshuarve, dhe pasi që shumë shpesh personi që e fiton bukën e gojës për familjen është burri, kjo e vë autoritetin e tij në dyshim. Në anën tjetër, ajo që është e qartë është se shtëpitë e të moshuarve nuk janë zgjidhje e problemit më të gjerë të kujdesit ideal për të moshuarit në Kosovë dhe të zbutjes së barrës financiare dhe sociale për familjet. Andaj, fokusi duhet të jetë në shërbime sociale falas, të specializuara dhe sistematike që synojnë edhe të moshuarit dhe në veçanti ato gra mbi të cilat rëndom bie barrë e përkujdesjes për të moshuarit. Kjo në anën tjetër do të zvogëlonte pjesërisht varësinë e të moshuarve nga familjet e tyre gjithashtu.

Gjetja e mjeteve për të moshuarit që ata të ruajnë apo të rikthejnë një pjesë të pavarësisë së tyre, si fizike, sociale ashtu edhe financiare është kyçe për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë. Për një vend të varfër, barra mb.

familjet për t'u kujdesur për të moshuarit, me pak ndihmë nga shteti, është tashmë problematike dhe ndërsa rritet përqindja e të moshuarve ky problem do të jetë edhe më i theksuar. Megjithatë, për zhvillimin e shërbimeve dhe të kushteve të nevojshme nevojitet vëmendja politike. Në këtë moment, popullsia 65-plus përbën 8% të numrit total të votuesve


A dini të lexoni dhe të shkruani?
Burrat dhe gratë



²⁸ IKS Anketa e Standardeve të Jetesës së të Moshuarve në Kosovë, 2017.

²⁹ Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2014 për Punën dhe Kriteret e Vendosjes së Rezidentëve në Shtëpitë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet, Neni 5 dhe 6.

në Kosovë.³⁰ Deri më sot, të gjitha partitë e kanë shpërfillur këtë pjesë të shoqërisë. Andaj, zëri i tyre nuk dëgjohej dhe interesat dhe të drejtat e tyre shpërfillen. Mbase një element shumë i rëndësishëm është fakti se një pjesë e madhe e këtij segmenti të popullsisë nuk është shumë e arsimuar. Nga mostra jonë, 38% e grave nuk kanë vijuar arsim të rregullt dhe prej tyre 66% janë analfabete. Te burrat, 9% nuk kanë vijuar arsim të rregullt dhe prej tyre 77% janë analfabetë.³¹



Në këtë kontekst, bëhet më i qartë fakti përse ata dhe interesat e tyre janë shpërfillur. Në Kosovë ekziston Sindikata e Pensionistëve si dhe Shoqata e Pensionistëve, por sindikata nuk ka peshë politike derisa shoqata është më shumë një klub social se një organizatë militante që kërkon respektimin e të drejtave të pjesëtarëve të saj. Deri më sot, partitë politike i kanë përqendruar energjitë e tyre në kërkimin e votës së të rinjve mbi të gjitha, dhe ka pasur pak interesim apo vetëdijësim për këtë segment të elektoratit, qoftë në programe të partisë qoftë në qeveri. Kur ky segment adresohet, kjo rëndom ka të bëjë me mirëqenien dhe rritjen e pensioneve. Specifikat sa u përket shërbimeve të ofruara dhe korniza të qarta e afatgjata politike mungojnë në masë të madhe. Kosova, gjithashtu nuk ka parti të pensionistëve, ndryshe nga vendet e tjera në regjion, përkundër faktit se po të ishin të bashkuar, 8% e elektoratit do të kishte fuqi të konsiderueshme në një sistem i cili partive të vogla u jep fuqi shumë të madhe.

Arsyeja për këtë është vizioni i përgjithshëm negativ i të moshuarve dhe, në një vend të mbizotëruar nga të rinjtë, krijohet besimi se pasi pensionistët përbëjnë një përqindje aq të vogël të popullsisë ata nuk meritojnë investime politike, sociale apo financiare. Ky është një

³⁰ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2017 <http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-e-pergjithshme>.

³¹ IKS Anketa e Standardeve të Jetesës së të Moshuarve në Kosovë, 2017.

gabim i madh, edhe për faktin se demografia e Kosovës po ndryshon. Deri në vitin 2050, sipas Agjencisë Statistikore të Kosovës, nataliteti në rënie do të thotë se shifrat e të moshuarve gati do të katërfishohen duke arritur më se 424,872 persona apo 23% të popullsisë.³² Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 20% e të moshuarve në botë ballafaqohen me çrregullime neurologjike apo mendore dhe rreth 5-7% vuajnë nga dementia. Nëse këto shifra pasqyrojnë edhe situatën në Kosovë, atëherë me probleme të tilla sot ballafaqohen më se 8,000 persona e deri në vitin 2050 kjo shifër do të arrijë 20,000-30,000 persona që vuajnë nga dementia. Për fat të keq, sidomos kur marrim parasysh numrin e të prekurve, nuk ka të dhëna për numrin e personave që vuajnë nga dementia në Kosovë.

Arsyeja tjetër për plakjen e popullsisë sonë është se derisa shumë të rinj po largohen, shumë të moshuar po kthehen nga diaspora për të dalë në pension dhe ky numër do të pësojë rritje³³. Duke marrë parasysh kontekstin që po ndryshohet, ka ardhur koha që qeveria të nisë planifikimin për të ardhmen në të cilën përbërja e popullsisë do të jetë shumë më ndryshe nga ajo që është sot. Sot, vendi ka mundësi të zhvillojë gradualisht struktura adekuate dhe sistem të sigurisë sociale dhe të kujdesit i cili i kushtohet numrit në rritje të të moshuarve e jo, duke qenë i papërgatitur për të ardhmen, të ballafaqohet me probleme serioze të varfërisë në mesin e të moshuarve që tashmë ka efekte negative në gjendjen financiare dhe sociale të familjeve të tyre, në ekonomi dhe në zhvillim të vendit në përgjithësi. Problemet fillestare që ekzistojnë sot rrezikojnë të përshkallëzohen në të ardhmen nëse ne nuk jemi gati.

³² Agjencia Statistikore e Kosovës, Rezultatet e Parashikimit të Popullsisë në Kosovë, 2011-2061 <http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/parashikimi-i-popullsisë-ne-kosove-2011-2061>.

³³ Agjencia Statistikore e Kosovës, Migrimi Kosovar, 2014

<http://kosovo.iom.int/sites/default/files/Migrimet%20English%20FINAL%2013082014.pdf>

PËRFUNDIMET

Standardet e këqija të jetesës të të moshuarve kosovarë janë rezultat direkt i pensioneve të vogla, varfërisë së shumëpërhapur dhe i varësisë nga familjet e tyre të cilat shpeshherë ballafaqohen me vështirësi për t'u përkujdesur për fëmijët e tyre, e të mos flasim për prindërit e tyre. Përveç pensioneve të ulëta, qeveria përgjithësisht ka hequr dorë nga përkujdesja për të moshuarit tanë siç kanë bërë edhe organizatat ndërkombëtare. Në mungesë të të dhënave, hulumtimi siguroi vetëm të dhënat për pensionin gjerman, nga i cili në vitin 2016 vareshin 9,757 të moshuar, derisa 9,575 të moshuar vareshin nga ky pension në vitin 2015. Entet e specializuara si shtëpi të të moshuarve nuk janë të përshtatura si duhet me kontekstin social të vendit. Familjet e shohin si obligim përkujdesjen për të moshuarit dhe dërgimi i të moshuarve në këto shtëpi shihet me sy të keq, duke u parë si një veprim i cili e turpëron familjen. Në kontekstin e Kosovës së sotme, ata kanë pak ndikim në zvogëlimin e barrës sociale dhe financiare e cila është rezultat i përkujdesjes për anëtarët e moshuar të familjes.

Shërbimet e tjera sociale ende nuk janë zhvilluar sa duhet, dhe ato janë ose minimale ose thjesht nuk ekzistojnë. Disa prej modeleve më të mira për përkujdesjen ndaj të moshuarve ofrohen nga qeveria suedeze. Për shembull, atyre të cilët nuk mund të përdorin transportin publik për ndonjë arsye u ofrohen taksit apo veturat e posaçme për të udhëtuar në qytet. Kjo kryesisht u kushtohet njerëzve me nevoja të veçanta. Në Irlandë, pensionistët gjithashtu mund të marrin ndihmë në kushte të veçanta përmes beneficioneve siç është pagesa e derivateve dimërore, që u ndihmon të moshuarve të paguajnë faturat e ngrohjes gjatë dimrit³⁴. Maqedonia ka siguruar kujdes social për të moshuarit përmes angazhimit të sektorit privat, që njihet si kujdes shtëpiak privat. Këto shërbime janë pjesë e rrjetit të shërbimeve sociale nën ombrellën e Ministrisë së Punës dhe të Politikave Sociale dhe kostot për këto shërbime mbulohen me para në dorë. Njerëzit në rrethana të kujdesit shtëpiak mund të aplikojnë për një përfitim të të hollave në rastet kur i plotësojnë kushtet, për të pranuar shërbime kujdesi nga palët e treta nga 60 deri në 70 euro në muaj pranë Qendrës Rajonale për Punë Sociale për t'i mbuluar disa prej shërbimeve.³⁵ Gjithashtu, në këtë aspekt ka bashkëpunim ndërmjet

³⁴ Pagesa e derivateve dimërore, Qeveria e Irlandës <https://www.gov.uk/winter-fuel-payment>

³⁵ Kostova, Chichevalieva, Ponce, & Winkelmann, 2017, p. 106

institucioneve publike dhe organizatave joqeveritare. Që nga viti 2009, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale në bashkëpunim me organizatën joqeveritare Humanity në Shkup, ka nisur përkujdesjen e komunitetit për të moshuarit përmes kujdestarëve të trajnuar shtëpiakë, të cilët në bazë të kërkesës i vizitojnë të moshuarit në shtëpitë e tyre dhe ofrojnë shërbime të higjienës personale, përgatitje të ushqimit, etj³⁶. Si rezultat i kësaj, ka kujdes të shtuar social ku përfshihen aktorë të ndryshëm.

Megjithatë, në Kosovë, zhvillimi i politikave qeveritare që kanë për synim përmirësimin e standardeve të jetesës së të moshuarve varet nga interesi dhe angazhimi politik. Deri më sot, vullneti politik për të punuar në këtë sektor nuk ka qenë i pranishëm edhe pse me 8-përqindëshin e elektoratit që është në rritje është e qartë se ka potencial për mobilizim politik të të moshuarve për këdo që vendos ta zhvillojë atë.

Përveç mosinteresimit të përgjithshëm dhe diskriminimit me të cilin ballafaqohen të moshuarit, gratë diskriminohen edhe më shumë si pasojë e normave sociale të cilat shpeshherë i privojnë ato nga posedimi i pronës. Natyra e historisë së punës së tyre ka për rrjedhojë pensione të ulëta dhe kjo përgjithësisht i lë ato në situatë më të keqe ekonomike se burrat, e që rëndom i bën edhe me shëndet më të dobët. Ndër kategoritë e cënueshme, gratë e moshuara janë më të prekurat. Diskriminimi gjinor është i pranishëm në shoqëri në përgjithësi, por kur gratë nuk janë në gjendje t'i zhbllokojnë asetet e tyre financiare siç është prona dhe si rrjedhojë të kujdesen për veten, pasojat mund të jenë dramatike nëse familja i largon ato nga gjiri i vet dhe ato bien në varfëritë skajshme.

Është detyrë e shoqërisë në përgjithësi dhe e qeverisë në veçanti të sigurojnë nivel të duhur të kujdesit për çdo qytetar nga lindja deri në vdekje. Të moshuarit kosovarë shpërfillen dhe kanë nevojë për vëmendje në këtë moment e kjo kërkon veprime nga qeveria jonë. Por, gjithashtu kemi nevojë për krijim të politikave të cilat planifikojnë për dekadat në vijim, e jo vetëm për zgjedhjet e ardhshme. Përveç Shqipërisë, secili fqinj i yni dhe pjesa më e madhe e Europës ka popullsi të vjetër në moshë e edhe Kosova po shkon në po këtë drejtim. Për t'u kujdesur për 23% të njerëzve tanë të cilët do të mbushin 65 vjet deri në vitin 2050, ne duhet ta planifikojmë e të punojmë tash që të kujdesemi për ta nesër.

³⁶ Kostova, Chichevalieva, Ponce, & Winkelmann, 2017, p. 105

BIBLIOGRAFIA

- J Boletini, E. (n.d.). Adresa e vetmisë: Shtëpia e Pleqve – azili i të harruarve. Prishtinë, Kosovë: www.telegrafi.com. Shikuar më 20 tetor, 2017, në: <https://telegrafi.com/adresa-e-vetmise-shtepia-e-pleqve-azili-i-te-harruarve-foto/>
- J Gjeçovi, S. (1999). *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Shkodër: Shtëpia botuese "kuvendi".
- J Halili, N. (2015, prill 2). Adresa e vetmisë: Shtëpia e Pleqve – azili i të harruarve . (E. Boletini, Intervistuesi)
- J Mehmeti, B. (2016, maj 1). Traditat dhe shtëpitë e pleqve - Të moshuarit shqiptarë vështirë e lëshojnë familjen! (RTV21, Intervistuesi)
- J Pejçinov, M. (2017, maj 2). Të moshuarit shqiptarë vështirë për të jetuar në shtëpitë e pleqve . (V. Ramadani, Intervistuesi)
- J Ramadani, V. (2016, shkurt 5). *Telegrafi*. Gjetur tetor 20, 2017, nga <https://telegrafi.com/te-moshuarit-shqiptare-veshtire-per-te-jetuar-ne-shtepite-e-pleqve-video/>
- J Ritzer, G. (1996). *Teoria Sociologjike*. Singapor: McRaë - Hill - Botime Ndërkombëtare. www.tv21.tv. (2016, maj 1).
- J Traditat dhe shtëpitë e pleqve - Të moshuarit shqiptarë vështirë e lëshojnë familjen! Kumanovë, Maqedoni, Maqedoni.
- J Angier, N. (2013). *Ndryshimi i familjes amerikane*. Nju Jork: New York Times .
- J Cherlin, A. J. (2013, nëntor 25). Ndryshimi i familjes amerikane. (N. Y. Times, Intervistuesi)
- J Kembrixhit, U. i. (2017, tetor 26). *Fjalori i Kembrixhit*. Nxjerrë nga: <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/nuclear-family>
- J Kristina. (2013, nëntor 18). Gjetur në KURIR: <http://kurir.mk/en/?p=13422>
- J Ligji_Nr.2004/32, K. i. (2006). *Ligji për Familjen i Kosovës*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare.
- J OECD. (2019). *Familjet po ndryshojnë*. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik OECD.

Shtojcë - Anketa e Standardeve të Jetesës së të Moshuarve

A1. Emri dhe Mbiemri:

A2. Kontakti:

A3. Gjinia:

Femër

Mashkull

A4. Moshë:

65-70

76-80

Mbi 90

71-75

81-90

A5. Nëse nuk e dini moshën: Viti i lindjes? _____ (saktëso!)

A6. Përkatësia juaj etnike:

Shqiptar/e

Rom/e, Ashkali/e,

Tjetër: _____

Serb/e

Egjiptian/e

(saktëso!)

Boshnjak/e

Turk/e

A7. Vendbanimi juaj:

Rural

Urban

A8. Gjendja juaj civile:

I/e martuar

I/e ve

Beqarë

Bashkëjetesë e lirë

I/e shkukurëzuar

A9. Niveli i edukimit shkollor:

Shkollën fillore

Bachelor

Nuk kam përfunduar

Shkollën e mesme

Master

shkollën fillore

Shkollën profesionale

Doktoratë

A10. Nëse nuk keni ndjekur fare shkollë, dini të lexoni dhe shkruani?

Po

Jo

B1. Ju jetoni në:

Shtëpi

Shtëpi për të moshuar

(saktëso!)

Banesë

Tjetër _____

B2. Objekti i banimit është në pronësi të:

Juaj

Jetoj në

Tjetër

Prindërve tuaj

banesë/shtëpi me qira

Bashkëshortes

Djalit

(saktëso!)

Bashkëshortit

Vajzës

B3. (PYETNI VETËM NËSE JETON ME QIRA) Sa paguani për qiranë në muaj? _____ (saktëso!)

B4. (PYETNI VETËM NËSE BANON NË SHTËPI APO BANESË) Sa është hapësira e vendbanimit ku ju jetoni (në metër katrorë)? _____ (metra katrorë)

B5. (PYETNI VETËM NËSE BANON NË SHTËPI APO BANESË) A jetoni në bashkësi?

Po

Jo

B6. (PYETNI VETËM NËSE JETOJNË NË BASHKËSI) Nëse po, sa është numri i anëtarëve të familjes më të cilët jetoni në bashkësi?

1

3

5

2

4

Më shumë se 6

B7. (PYETNI VETËM NËSE BANON NË SHTËPI APO BANESË) Sa nga anëtarët e familjes më të cilët bashkëbanoni janë të moshës 65 vjeç apo më lart? (pa përfshirë vetën) _____ (saktëso!)

B8. (PYETNI VETËM NËSE BANON NË SHTËPI APO BANESË) A keni dhomë të veçantë për fjetje?

Po

Jo

B9. (PYETNI VETËM NËSE BANON NË SHTËPI APO BANESË) A jeni të kënaqur me kushtet e banimit?

Po

Jo

B10. (PYETNI VETËM NËSE BANON NË SHTËPI APO BANESË) Nëse Jo, pse?

Furnizimi jo i rregullt me energji elektrike

Furnizimi jo i rregullt me ujë

- Furnizimi jo i rregullt me ngrohje
Higjiena (pastërtia, mbeturinat, etj.)
Trajtimi/raporti jo i mirë nga/me anëtarët e familjes
- Zhurma
Tjetër _____
(saktëso!)
- B11. (PYETNI VETËM NËSE BANON NË SHTËPI APO BANESË) A keni nevojë për përkujdesje?
Po Jo
- B12. Nëse po: Kush përkujdeset për ju:
Bashkëshorti/ja Kam angazhuar kujdestarë me pagesë
Djali Të afërmit
Vajza Tjetër _____ (saktëso!)
- B13. Nëse keni angazhuar kujdestare me pagesë, sa është shuma që paguani?
0-50 € 151-200 € 501-600 €
51-80 € 201-300 € Më shumë se 600 €
81-100 € 301-400 €
101-150 € 401-500 €
- B14. (PYETNI VETËM NËSE BANON NË SHTËPI PËR TË MOSHUAR) Sa është hapësira e vendbanimit ku ju flini (në metër katrorë)? _____ (saktëso!)
- B15. (PYETNI VETËM NËSE BANON NË SHTËPI PËR TË MOSHUAR) A jeni të kënaqur me kushtet e banimit?
Po Jo
- B16. (PYETNI VETËM NËSE BANON NË SHTËPI PËR TË MOSHUAR) Nëse Jo, pse?
Hapësira e vogël për banim Higjiena (pastërtia, mbeturinat, etj.)
Furnizimi jo i rregullt me energji elektrike Ushqimi jo adekuat apo jo i shëndetshëm
Furnizimi jo i rregullt me ujë Tjetër _____ (saktëso!)
- B17. A paguani për ndonjë shërbim në këtë institucion?
Po Jo
- B18. Nëse po, për çfarë paguani?
Përkujdesje Pagesë mujore
Medikamente Tjetër _____ (saktëso!)
- B19. Nëse po, sa është shuma që paguani në muaj? _____ € (saktëso!)
- B20. Kush i merr përsipër shpenzimet?
Paguaj nga të Miq Tjetër
ardhurat e mia Institucionet publike _____
Familja Organizata (saktëso!)
- C1. Profesionin që keni ushtruar para pensionimit: _____ (saktëso!)
- C2. Nëse keni punuar, në cilën periudhë kohore keni punuar? (nga) _____ (deri) _____ (saktëso VITET!)
- C3. A jeni aktiv në tregun e punës për momentin/a jeni duke punuar? (Duke punuar d.m.th. se punojnë për të holla të gatshme apo për shpërbim në shkëmbim/sendë/mallra). Këtu përfshihet puna në tokën apo biznesin familjar apo puna në ndonjë pozitë tjetër e cila nuk është e paguar, nëse pagesat bëhen ndryshe (me ushqim, strehim, tokë, etj.).
Po Jo
- C4. Nëse po, ku punoni?
Punon vendin e punës që ka punuar Punon punë vullnetare
para pensionimit Tjetër _____
Biznes të familjes (saktëso!)
- C5. (NËSE NUK PUNON) Nëse do t'ju ofrohej punë, a jeni të gatshëm të punoni?
Po Jo
- C6. Sa janë të ardhurat tuaja mujore?
€0 - €70 €151 - €200 Më shumë se €500
€71 - €100 €201 - €250
€101 - €150 €250 - €500
- C7. Nga i siguronit të ardhurat? (specifiko)
Skema e pensioneve bazike të moshës

Skema e pensioneve kontribut pagues të moshës
 Skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuar
 Skema për mbështetje materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme
 Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve të luftës
 Skema e pensioneve të Trepçës

Skema e pensioneve për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, të Forcës së Sigurisë së Kosovës
 Skema e kompensimeve për personat e verbër
 Skema e ndihmës sociale
 Pension i jashtëm
 Punoj
 Familja
 Diaspora
 Kursime
 Tjetër: _____ (saktëso!)

C8. (VETËM PËR ATA QË JETOJNË NË BASHKËSI) A jeni ju personi i vetëm në familje me të ardhura të rregullta?

Po

Jo

C9. A keni hasur në vështirësi gjatë procedurave të pensionimit?

Po

Tjetër: _____ (saktëso!)

Jo

C10. Me të ardhurat nga pensioni apo tjera, a mendoni se ju garantohet një minimum i mirëqenies sociale?

Plotësisht

Aspak

Mesatarisht

Refuzoj të përgjigjem

Pak

C11.	USHQIMI JAVOR I BLERË: Sa harxhoni si ekonomi familjare në javë për ushqim ?	_____ Shëno shumën në €
C12.	USHQIMI I PRODHUAR VET: Cilat produkte i prodhoni ne shtëpi? Cila është vlera e ushqimit të kultivuar/prodhuar nga amvisëria e juaj çdo vit? Ose, thënë ndryshe, nëse e shisni atë ushqim të prodhuar, çfarë do të ishte vlera e shitjeve? Përfshini vlerën e ushqimit të cilin e merrni rregullisht si dhuratë dhe e konsumoni në amvisërinë tuaj.	_____ Shëno shumën në €
C13.	TRANSPORTI JAVOR: Sa harxhoni për transport çdo javë? Përfshini transportin publik, taksitë, karburantin, dhe shpenzimet e mirëmbajtjes së mjetit të transportit. <i>Nëse aktiviteti i biznesit të klientit është transporti, mos përfshini shpenzimet e biznesit.</i>	_____ Shëno shumën në €
C14.	QIRAJA MUJORE: Sa harxhoni çdo muaj për të marrë me qira shtëpinë, banesën, tokën? Mos përfshini qiranë për dyqane, tokë bujqësore apo hapësira tjera prodhuese.	_____ Shëno shumën në €
C15.	SHPENZIMET PËR SHËRBIME PUBLIKE: Sa harxhoni për shërbimet publike (ujë, rrymë, gaz, plehra) në muaj? <i>Nëse keni biznes që ka harxhime të mëdha për shërbime komunale, atëherë përfshini ato në shpenzime biznesi dhe llogaritni vetëm ato të cilat përdorën për ngrohje, ndriçim dhe gatim në amvisëri</i>	_____ Shëno shumën në €
C16.	TË MIRA: Sa harxhojnë anëtarët e amvisërisë tuaj në pastrim, furnizime apo gjësende personale si sapuni, shampon apo produkte tjera higjienike në muaj?	_____ Shëno shumën në €
C17.	TELEFON: Sa harxhojnë anëtarët e amvisërisë tuaj për telefonata (fiks apo celular) apo për mënyra tjera komunikimi? <i>(Vlerëso shumat nëse nuk jeni të sigurt nga ajo që e thotë klienti)</i>	_____ Shëno shumën në €
C18.	SHTËPI: Sa harxhoni çdo vit në riparime apo përmirësime shtëpiake?	_____ Shëno shumën në €
C19.	VESHMBATHJE: Sa harxhojnë anëtarët e amvisërisë suaj në veshmbathje çdo vit? <i>(mos përfshini uniformat e shkollës).</i>	_____ Shëno shumën në €
C20.	ARSIM: Sa harxhoni në arsimim (pagesa shkolle, furnizime dhe uniforma shkollore për të gjithë fëmijët në amvisërinë e juaj)?	_____ Shëno shumën në €
C21.	TJERA. Sa shpenzojnë anëtarët e amvisërisë suaj në për argëtim, taksa, dhe dhurata çdo vit? <i>Mos përfshini pagesat e borxheve ose interesin e borxheve.</i>	_____ Shëno shumën në €

C22. Sipas jush, sa i lartë duhet të jetë një pension mujor në mënyrë që të mbulojë nevojat bazike?

- 0-50 Tjera _____
 51-60 (saktëso!)
 61-70
- D15. Nëse nuk mundeni ta mbuloni shpenzimet për barna apo ndonjë shërbim mjekësor, kush ju ndihmon me shpenzimet?
 Familja Institucione publike
 Organizata humanitare Tjetër _____ (saktëso!)
 Shok
- D16. Sa para nga të ardhurat tuaja mujore i shpenzoni për barna dhe shërbime shëndetësore?
 1-20€ 61-80€ 151-200€
 21-40€ 81-100€ 200-400€
 41-60€ 101-150€ Mbi 400€
- D17. A posedoni sigurim shëndetësor privat?
 Po Jo
- D18. Nëse Po, ku jeni të siguruar?
 Jashtë vendit Kompani private vendore sigurimesh
 _____ (saktëso!)
- D19. Sa është e mundshme që të mos merrni shërbimin mjekësor që do t'ju nevojitet në rast se e nevojshme në 12 muajt e ardhshëm?
 Aspak e mundshme Shumë e mundshme
 Disi e mundshme Nuk e di
- E1. (PYET VETËM NËSE JETON NË SHTËPI APO BANESË) A jeni në dijeni për ekzistimin e shtëpive për të moshuar në vendin tonë?
 Po Jo
- E2. Nëse po, a janë të mjaftueshme për Kosovën?
 Po Jo Nuk e di
- E3. (VETËM PER ATA QË BANOJNË NË SHTËPI PËR TË MOSHUAR) Sa jeni të kënaqur me shërbimet e ofruara?
 Shumë të mira Aspak të mira Refuzoj të përgjigjem
 Mesatarisht të mira Nuk e di
- E4. A keni në dijeni për ekzistimin e organizatave që ofrojnë shërbime për të moshuarit?
 Po Jo
- E5. Nëse Po: Cila organizatë ju ka ofruar shërbime? _____ (saktëso!)
- E6. Nëse Po, në çfarë forme?
 Transport Pajisje Përkujdesje
 Shërbim ambulant Këshilla Tjetër _____
 Medikamente Veshje _____ (saktëso!)
- E7. Nëse Po: Si keni kontaktuar me këto organizata
 Përmes miqve Përmes kontakteve në institucione publike
 Përmes vizitës Fushata vetëdijesimi
 Përmes reklamës (gazetë, televizion, radio, internet) Tjetër _____
 (saktëso!)

	Pajtohem plotësisht	Më shumë pajtohem se sa nuk pajtohem	Neutral	Më shumë nuk pajtohem se sa pajtohem	Nuk pajtohem aspak
F1. Familja, miqtë apo fqinjët e mi do të më ndihmonin nëse do të ishte e nevojshme					
F2. Do të dëshiroja të zgjeroj më shumë rrethin shoqëror					
F3. Kam dikë që më jep dashuri dhe përkushtim					
F4. Dëshiroj të kem më shumë njerëz përreth që ta shijoj jetën me ta					
F5. Kam fëmijët përreth, që është shumë e rëndësishme					

F6. Cilat janë interesimet e juaja të veçanta (hobit)

Leximi	Vizitohet të afërmit, shoqërinë	Ndjekja e kurseve/arsimim
Kopshtaria		
Sporti dhe ecja	Arti (Piktura, fotografia)	Tjetër _____(saktëso!)
Muzika	Lojërat e ndryshme si: shahu, kartat, fjalëkryqet, bingo etj.	
Televizioni		

F7. Sa herë dilni në kafene apo shkoni në ndonjë aheng?

Çdo ditë	Disa herë në muaj	Asnjëherë
Disa herë në javë	Disa herë në vit	

F8. Sa herë shkoni në teatër, kinema apo koncert?

Çdo ditë	Disa herë në muaj	Asnjëherë
Disa herë në javë	Disa herë në vit	

F9. A keni blerë dhuratë për dikë në vitin e fundit?

Po

Jo

	Pajtohem plotësisht	Më shumë pajtohem se nuk pajtohem	Neutral	Më shumë nuk pajtohem se pajtohem	Nuk pajtohem aspak
G1. Jam mjaft i/e shëndetshëm/e që të jetoj pavarësinë time					
G2. Ndjehem i/e sigurt aty ku jetoj					
G3. Dyqanet dhe shërbimet publike janë lehtë të qasshme për mua					
G4. Ndjehem mirë në shtëpinë time					
G5. Banorët në lagjen time janë shumë miqësor					

G6. A jeni anëtar i ndonjë organizate apo shoqate që i përgjigjet hobit/interesimeve tuaja?

Po

Jo

G7. Nëse Po, në cilat: _____ (saktëso!)

H1. Si mendoni, sa janë aktive institucionet e shtetit në kujdesin për të moshuarit?

Plotësisht

Mesatarisht

Pak

Aspak	Nuk e di	
H2. Shteti ka përgjegjësinë për të siguruar mbrojtje adekuata për të moshuarit?		
Nuk pajtohem aspak	Neutral	Pajtohem plotësisht
Më shumë nuk pajtohem se sa pajtohem	Më shumë pajtohem se sa nuk pajtohem	Nuk e di
H3. A mendoni që shoqëria duhet të jetë më aktive me punë vullnetare në ndihmë/përkrahje për moshuarit?		
Plotësisht	Pak	Nuk e di
Mesatarisht	Aspak	



Sylejman Vokshi,
Nr. i hyrjës 50/5,
Prishtina, Kosovë



381 38 260 600



IKSweb.org



Iniciativa Kosovare
per Stabilitet - IKS